

NEWSLETTER PROGRAMI CONNECT ALBANIA

2021

Nr. 9



CONNECT
ALBANIA

Connect Albania (CA)

Shënim për lexuesin:

Connect Albania po vazhdon me aktivitetet e saj me komunitetet e diasporës dhe kjo është reflektuar në një interes të shtuar nga individë prej Diasporës Shqiptare për tu bërë Agjentë Zhvillimi duke kontribuar në këtë mënyrë në zhvillimin e atdheut të tyre. Z. Rezart Ujkaj u bashkua së fundmi me ekipin e Agjentëve të Zhvillimit me besimin që do të përdorë më së miri rrjetin dhe përvojat profesionale për tërheqjen e investitorëve italianë dhe atyre nga Diaspora Shqiptare të investojnë në Shqipëri. Lista e plotë e Agjentëve të Zhvillimit mund të gjendet në link-un:

<https://www.adbc.al/regjistri-publik-i-agjenteve-te-zhvillimit-te-inte-resuar/>

Rezart Ujkaj

Z. Ujkaj lindi në Koplik, qytet në veri të Shqipërisë. Ai mbaroi shkollën e mesme në qytetin e lindjet në vitin 2003 dhe që atëherë u zhvendos në Itali ku kryetun në universitet. Duke qenë mjafet i vendosur për të patur rezultate sa më të larta, ai përfundoi dhe u diplomua për Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin Katolik të Milanos. Menjëherë pas kësaj, ai ndoqi dhe përfundoi studimet master për Ekonomi Politike dhe Institucione Ndërkombëtare pranë Universitetit të Pavis. Që në atë kohë ka qenë një student i shquar për angazhimin e tij në aktivitetet studentore duke qenë edhe president i Unionit Studentor në Varese.

Pas përfundimit të studimeve ai filloi karrierën profesionale në sektorin e sigurimeve. Me kalimin e kohës u specializua në ofrimin e konsulencës për Menaxhimin e Riskut në fushën e sigurimeve për bizneset e vogla dhe të mesme. Zgjerimi i rrjetit dhe njohjeve profesionale i krijoi mundësinë që të ketë një rang të gjerë bashkëpunëtorësh dhe partnerësh sidomos në sektorin e biznesit. Gjithashtu duke qenë mjafet aktiv nga pikëpamja shoqërore, ai arriti që në mënyrë të natyrshme të përfshihej edhe në aktivitetet e Diasporës Shqiptare. Në vitin 2013 ai ishte pjesë e grupit themelues të shoqatës "Shqipëria ime" në Varese. Në kuadër të shoqatës ai vazhdimisht ka organizuar takime dhe aktivitete për promovimin e Shqipërisë dhe kulturës së saj. Tashmë si një Agjent Zhvillimi ai do të intensifikojë dhe fokusojë aktivitetet e tij për promovimin e Shqipërisë tek investitorët e mundshëm në Itali duke përfshirë këtu edhe anëtarët dhe sipërmarrësit e Diasporës Shqiptare, për të investuar ose operuar në atdheun e tij.


"Ne fillimisht duhet të përdorim rrjetet tona profesionale për të ndryshuar imazhin e Shqipërisë si një destinacion investimi ku ka një klimë të përmirësuar të të bërit biznes, më pak kërkesa burokratike nga administrata publike dhe më shumë mundësi për tu shfrytëzuar. Atëherë do të jetë më e lehtë për të tërhequr investitorë nga Italia dhe Diaspora Shqiptare".



Takimi i Agjentëve të Zhvillimit që operojnë në Itali

Në datë 18 Qershor, Agjentët e Zhvillimit që veprojnë në Itali patën mundësinë të bënin një takim online me përfaqësues të Zyrës së Connect Albania në Tiranë. Ata diskutuan rreth mundësive, sfidave dhe mbështetjeve së nevojshme për të tërhequr dhe lehtësuar afrimin e investimeve të huaja në Shqipëri. Për më shumë detaje rreth këtij takimi interesant mund të klikoni në link-un:

<https://www.adbc.al/takimi-midis-agjenteve-te-zhvillimit-dhe-zyres-programit-connect-albania/>



Mekanizmi i Connect Albania është një pjesë e rëndësishme e programit "Angazhimi i Diasporës në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë". Ai synon të kontribuojë në rritjen e investimeve të huaja në Shqipëri. Programi zbatohet nga Zyra në Shqipëri e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) – Agjencia e Migrimit e OKB-së, me financimin e Ministrisë Italiane për Punët e Jashtme dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrin e Shtetit për Diasporën të Shqipërisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si edhe Agjencinë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS).

